



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:021422

Datë: 24.03.2022

Numri i dokumentit: 02836401

P.nr.875/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjyquese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit H.K. nga Prizreni, me nr.personal për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1130-4/2018 të datës 30.05.2018, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Sh.D. të akuzuarit dhe mbrojtësit të autorizuar av.A.H. nga Prizreni, më datë 24.02.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.13.03.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H.K. nga i ati Z. dhe e ëma R. e vajzërisë K. i lindur me në fshatin Komuna e Prizrenit, tani jeton në Prizren, rr. ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në “Hidroregjionin Jugor”, i martuar, i ati i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 23.02.2018, në Prizren, në shtëpinë e tij e cila gjindet në rrugën “Alajdin Berisha”, pikërisht në biznesin e tij familjar, kopshtin e fëmijëve përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte, pa njehsor elektrik, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS-Departamenti Ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

-Këso dore ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi I të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 46 par.1 nënpar. 1.1, 47, 48, 49, 69 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari, në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i akuzuari H.K. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro dhe për programin e kompenzimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara KEDS -Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm-Prokurori i shtetit, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1130-4/2018 të datës 30.05.2018, kundër të akuzuarit H.K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale në veprën penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPK-së, në kuptim të nenit 3 të KPK-së si ligj më i favorshëm për të akuzuarin.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit-Sh.D. ka deklaruar se, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si ato personale, përkatësisht deklaratat e dëshmitarëve po ashtu edhe nga provat materiale, si procesverbalet, foto dokumentacioni në vendin e ngjarjes dhe provat tjera materiale, vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri H.K. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr.1130-4/2018 të datës 30.05.2018 e që në rastin konkret, ka bërë përmirësimin e përshkrimit faktik të aktakuzës, ashtu që në rreshtin e parë fjala “në shtëpinë e tij” duhet të plotësohet me fjalën “saktësisht në objektin të cilin e ka shfrytëzuar si biznes familjar-çerdhen duke kërkuar nga gjykata që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës KEDS-D.A. në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar ka deklaruar se në momentin e kontrollës nga ana e ekipit të KEDS me dt.23.02.2018, është konstatuar se konsumatori H.K. shfrytëzon energjinë elektrike pa njehsor elektrik, në mënyrë direkte dhe pas kontrollës tek konsumatori është vendosur njehsori elektrik me nr.67793761, ku po ashtu janë regjistruar edhe pajisjet e gjetura në ato momente. Gjendja faktike është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve L.B., A.G. dhe Sh.G. të cilët kanë deklaruar se gjatë kontrollës konsumatori ka qenë duke u furnizuar me energji elektrike pa njehsor elektrik, me lidhje direkte nga rrjeti elektrik nga shtylla kryesore. Dëshmitarët kanë deklaruar se kontrolli është kryer në prezencën e konsumatorit H.K. ku ndër të tjera në foton nr.1 shihet se energjia vjen pa matje në siguresa, në foton nr.2 shihet koridori i objektit nga brenda ku është dashur të jetë njehsori dhe në foton nr. 3 shihet se nuk ka pasur njehsor dhe energjia e shpenzuar përmes së cilës është furnizuar konsumatori nuk është regjistruar dhe faturuar. Sa i përket deklaratës së

dëshmitarit N.K. gjykata nuk duhet t'ia fal besimin për faktin se është kundërthënëse, ngase si ka mundësi që një person të furnizohet me energji elektrike në shtëpinë e dikujt-saktësisht në shtëpinë e dëshmitarit e të mos dihet periudha kohore se kush dhe kur po furnizohet, në cilin njehsor të tij po furnizohet pasi që i njëjti posedon dy shifra dhe këtë gjykatës ia kemi vërtetuar me prezantimin e transaksioneve në emër të N.K. ku vlen të theksohet se nëse me të vërtetë i akuzuari H.K. është furnizuar me energji elektrike nga njehsori i dëshmitarit N.K. si ka mundësi që shpenzimet mujore të dëshmitarit të mos ndryshojnë fare dhe të jenë të njëjta si para periudhës së dt.23.02.2018 e poashtu edhe pas kësaj periudhe. Në fund përfaqësuesja e të dëmtuarës, ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë duke shtuar se parashtronë kërkesë pasurore juridike për dëmin e pësuar material në lartësi prej 2,432.07 euro.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.A.H. në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të cilën e ka elaboruar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se dispozitivi i përshkruar në aktakuzë nga ana e prokurorit të shtetit nuk mund të qëndroj sepse është tërësisht i pa qartë, jo preciz dhe kontradiktor me vetveten, ngase prokuroria nuk ka arrit të përshkruan veprimet inkriminuese të të akuzuarit, nuk ka arrit të përcakton se vërtetë a ka pas dëm dhe nëse po sa është lartësia e dëmit, andaj qartë vërtetohet se prokuroria ka ngritur aktakuzën bazuar në kallëzimin penal të të dëmtuarës së pretenduar duke mos zhvilluar asnjë hetim, madje në shkresat e lëndës nuk kemi as aktvendim mbi fillimin e hetimeve. Nga të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri H.K. me asnjë veprim të tij nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se shtëpinë e tij në vitin 2016 e ka blerë nga një qytetar serb të cilën e ka rrënuar dhe njehsorin e saj me kërkesën e punëtorëve të KEDS-it e ka gjetur nga materialet e hedhura inerte dhe e ka dorëzuar në KEDS, ku pastaj ka ndërtuar shtëpinë e re për të cilën tri herë ka bërë kërkesë në KEDS për vendosjen e njehsorit të ri. I pandehuri duke parë nevojën për rindërtimin e shtëpisë, pasi që punëtorët e KEDS-it nuk kanë shkuar për t'ia vendosur njehsorin e ri, ka shfrytëzuar energjinë elektrike nga fqiu i tij N.K. i cili është faturuar për energjinë elektrike të shpenzuar nga H.K. dhe e ka paguar atë. Lidhur me këtë fakt është dëgjuar edhe dëshmitari N.K. i cili ka pohuar se i pandehuri është furnizuar me energji elektrike nga shtëpia e tij deri kur i është vendosur njehsori i ri dhe sipas këtij dëshmitari edhe sot ajo kablo është e shtrirë në tokë. Faktin dhe rrethanën se ditën kritike kanë qenë për kontroll punëtorët e KEDS-it e ka pohuar edhe vetë i pandehuri, por jo në kohën dhe numër sa ata thonë, e të cilët punëtor i kishte shoqëruar edhe vet i pandehuri duke ju treguar vendin për vendosjen e njehsorit dhe dy kabllo të cilat kanë qenë aty. Nga njëra kablo i pandehuri është furnizuar me energji elektrike nga N.K. ndërsa kablloja tjetër e cila ishte më e trashë dhe e izoluar ishte e gatshme për tu lidhur në njehsorin për të cilin i pandehuri ishte në pritje të tij. Punëtorët e KEDS-it me të parë këtë gjendje pa bërë kontrollin se nga e kanë burimin këto kablo veprojnë duke e vendosur njehsorin e ri dhe kërkojnë nga i pandehuri që ta nënshkruajnë procesverbalin dhe atë jo në vendin e duhur por në fillim të tij me arsyetim se ky proces ka të bëjë me vendosjen e njehsorit të ri. Faktin se në orman janë të vendosura dy kablo shihet edhe nga foto dokumentacioni i bërë nga punëtorët e KEDS-it, por që gjatë deklaratave të dhëna në gjykatë, të njëjtit për ta arsyetuar punën e tyre i shmangen të vërtetës duke dhënë deklaratat të pa sakta sa i përket kohës së kontrollës, faktit se a ishin dy apo tre punëtor në kontroll si dhe sa kablo ishin të vendosura në orman ku duhej vendosur njehsori e poashtu ku ishte burimi i energjisë për ato dy kablo. Pala e dëmtuar në mënyrë të paanshme pretendon se dëmi i shkaktuar është 2,432.07 euro i cili dëm asesi nuk duhet të merret parasysh nga gjykata sepse është subjektiv dhe se kalkulimi i dëmit pa tjetër është dashur të bëhet nga një ekspert për të cilën mbrojtja edhe ka propozuar gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe faktin se pse në ormanin e njehsorit në shtëpinë e të pandehurit janë gjendur dy kablo të cilin propozim gjykata e ka refuzuar dhe besoj se llogaritjen e dëmit nga vetë e dëmtuara gjykata do ta ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit. Më tej mbrojtja ka theksuar se i pandehuri ka pohuar faktin, se në shtëpinë e tij nuk ka pasur njehsor

elektrik, për arsye derisa shtëpinë ta bëjë të banueshme. Po ashtu gjykata duhet të ketë parasysh se i pandehuri nuk ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga shfrytëzimi i energjisë elektrike pa njehsor, ngase energjinë e shpenzuar e ka marrë nga fqiu i tij N.K. dhe deri te kjo situatë ka ardhur jo me qëllimin e të pandehurit por nga neglizhenca e vetë KEDS-it, i cili nuk ka vepruar edhe pas tri kërkesave të të pandehurit për vendosjen e njehsorit elektrik, ashtu që pasi që nuk ka qëllim dhe dashje në rastin konkret nuk ka as vepër penale, ngase vepra penale e kësaj natyre kryhet me dashje të drejtpërdrejtë. Andaj në mungesë të provave i ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza në përputhje me nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së.

I akuzuari H.K. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria Themelore në Prizren.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar provat dhe atë: deklaratën e përfaqësuesit të të dëmtuarës, deklaratat e dëshmitarëve: L.B., A.G. dhe Sh.G. deklaratën e dëshmitarit N.K. dhe provat materiale si: procesverbalin me nr.2317388 të dt.23.02.2018, faturën e kalkulimit RH të dt.07.03.2018, fatura e rikthimit të humbjeve me DPZHP 1812743 e dt.07.03.2018, transakcionet e konsumatorit me nr.1830 të dt.26.12.2018, kërkesat e dt.29.03.2016, dt.11.10.2017 dhe dt.06.11.2017, transakcionet e konsumatorit sipas DPZ-9046094 të dt.25.01.2022 dhe DPZ-1827 të dt.17.11.2021 në emër të N.(I) K. si dhe foto dokumentacionin në shkresat e lëndës dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç e duke i ndërlidhur të gjitha së bashku ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari H.K. ditën kritike, me datën 23.02.2018, në Prizren, në shtëpinë e tij e cila gjindet në rrugën “Alajdin Berisha”, pikërisht në biznesin e tij familjar, kopshtin e fëmijëve përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte, pa njehsor elektrik, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS-Departamenti Ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-B.P. gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se këtu i akuzuari H.K. ka pasur njehsorin elektrik me shifrën DPZ1830 i regjistruar në emër të B.L. ku në kundërshtimin nga ana e të akuzuarit në procedurë administrative i njëjti ka theksuar se njehsorin e ka asgjësuar me rastin e rrënimit të shtëpisë në vitin 2016, gjithashtu po në këtë kundërshtim pohohet fakti se objekti në fjalë është ndërtuar në vitin 2016, kurse gjendja faktike e hasur në teren është e dt.23.02.2018, ku objekti ka qenë i përfunduar dhe i banuar dhe gjendjen faktike i akuzuari e ka pranuar me rastin e nënshkrimit të vetë procesverbalit mbi të gjeturat e ditës kritike. Po ashtu përfaqësuesi i të dëmtuarës ka sqaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, se sa i përket faturimit të energjisë elektrike në lidhje me shpenzimin e energjinë elektrike për të akuzuarin, për kohën për të cilën akuzohet dhe ate bazuar nga transakcionet e konsumatorit, nga koordinatori i leximit të KEDS-it është sqaruar se shtypja e Case 3, nënkupton faturimin paushall kur lexuesi për arsye objektive nuk mund të arrin deri tek shtëpia, përkatësisht te pika matëse, e që në rastin konkret sipas koordinatorit shtëpia ka qenë e banuar, përkatësisht lokali i saj dhe në pamundësi të faturimit, faturimi është bërë paushall, për arsye të cilat ndoshta i din vetëm lexuesi i cili në mënyrë vullnetare ka ndërprerë marrëdhënie pune në KEDS dhe është larguar jashtë Kosove. Gjithashtu po në këtë periudhë lexuesi në fjalë ka prekur edhe Code 14 që nënkupton se rasti duhet të jetë për kontrollë dhe si duket si rrjedhojë e këtij butoni ka ardhur edhe deri te kontrolla e dt.23.02.2018.

Gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarit L.B. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me rastin e kontrollit të kryer tek konsumatori në fjalë me

dt.23.02.2018 kan hasur se i njëjti shfrytëzon energjinë elektrike në objektin e tij-kopshtin e fëmijëve “Arta”, pa njehsor elektrik dhe është furnizuar me energji nga rrjeti elektrik nga shtylla kryesore, me lidhje direkte, ashtu që energjia elektrike nuk është regjistruar dhe faturuar dhe pas evitimit të këtyre parregullsive, konsumatorit–këtu të akuzuarit ja kanë vendosur njehsorin e ri elektrik. Gjatë gjithë kohës derisa kanë zhvilluar kontrollimin në objektin e të akuzuarit së bashku me kolegët e tij, prezent ka qenë edhe vetë i akuzuari i cili edhe i ka shoqëruar dhe pas përpilimit të procesverbalit i njëjti e ka nënshkruar dhe nuk ka pasur ndonjë shpjegim në lidhje me të gjeturat dhe konstatimet nga ana e punëtorëve të KEDS-it, ku dëshmitari personalisht ia ka vendosur njehsorin e ri elektrik, ndërsa kolegët e tij kanë regjistruar edhe pajisjet e gjetura në objekt të cilat i akuzuari i ka pas në shfrytëzim, pa matje dhe pa faturim. Më tej dëshmitari ka sqaruar se fillimisht e kanë bërë verifikimin e kabllot e cila ka qenë me lidhje direkte nga shtylla kryesore dhe të cilën parregullsi dëshmitari e ka parë personalisht, ku pastaj të gjeturat në objekt i kanë konstatuar edhe në procesverbalin me nr.2317388 të dt.23.02.2018.

Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar gjithashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit A. G. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, i kujtohet kur kanë qenë në kontroll tek konsumatori H.K. së bashku me kolegët e tij dhe gjatë kontrollës kanë vërejtur se i njëjti ka qenë pa njehsor elektrik, i kyçur në rrjetin elektrik me lidhje direkte nga shtylla elektrike përmes rrjetit kryesor. Në atë rast konsumatori sa i kujtohet i ka njoftuar gojarisht se ka bërë kërkesë në KEDS për vendosjen e njehsorit, por sqarime lidhur me konstatimet e bëra nga ekipa e KEDS-it në ditën kritike nuk ka dhënë. Më tej dëshmitari ka deklaruar se njehsori i ri i vendosur nga ana e tyre është lidhur pikërisht në kabllon kryesore gjegjësisht në lidhjen direkte në pikën dhe vendin ku ka qenë pa njehsor konsumatori. Po ashtu verifikim e pajisjeve të cilat kanë qenë në shfrytëzim nga konsumatori e ka bërë dëshmitari së bashku me kolegun e tij, të cilat pajisje kanë qenë në shfrytëzim në katin e parë të objektit i cili ka qenë kopsht i fëmijëve ndërsa në katin e dytë nuk i ka lejuar konsumatori të bëjnë kontroll, me arsyetim se ka familjar. Dëshmitari ka theksuar se në fotot e bëra në vendin e ngjarjes ku rezulton se kabllot shpërndarëse kalojnë nga tri siguresa kryesore, nuk figurojnë siguresat shpërndarëse të energjisë që furnizohet objekti dhe aty vërehet se në dalje të siguresave kryesore ka përçues të çiftëzuar, ku kjo tregon se nga ky burim furnizohen katet apo tabelat shtesë me siguresa për të cilat ata nuk kanë mundur të verifikojmë katin e dytë siç ka sqaruar, për arsye se nuk i ka lejuar konsumatori, po ashtu në foton 3 dhe 4 vërehet furnizimi kryesor i energjisë elektrike dhe po te i njëjti përçues kryesor është vendosur njehsori elektrik nga ana e tyre. Në lidhje me ate se pse konsumatori është nënshkruar në hyrje të procesverbalit të dt.23.02.2018, e jo në rubrikën e konsumatorit, dëshmitari ka sqaruar se kjo ka ndodh për arsye se konsumatori ua ka prezentuar letërnjoftimin dhe është nënshkruar si shfrytëzues i energjisë elektrike, pasi që në shumicën e rasteve kur shifra e konsumatorit është e regjistruar në emër të personit tjetër, si në rastin konkret në emër të B.L. dhe për këtë arsye nuk figuron në fund të procesverbalit nënshkrimi i konsumatorit sepse po të kishte refuzuar i njëjti do ta kishin konstatuar në procesverbal se “refuzon”. Ndërsa sa i përket konstatimit si në procesverbal të dt.23.02.2018 ku është shënuar shifra 4/02 dhe shifra 7/02, dëshmitari ka sqaruar se kjo nënkupton se konsumatori në bazë të shifrës 1830, në KEDS ka qenë i regjistruar si shtëpi banimi me shifrën 4/02, derisa ata kanë hasur në vendin e ngjarjes, se ky konsumator ushtron veprimtari komerciale dhe duhet të kthehet në shifrën 7/02 ashtu që kanë prezantuar gjendjen faktike në teren sipas procesverbalit të konstatuar.

Gjendja faktike është vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarit Sh.G. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me dt.23.02.2018, së bashku me kolegët L.B. dhe A.G. kanë qenë për kontroll në lagjen dhe në objektin e konsumatorit H.K. i cili ishte çerdhe fëmijësh dhe furnizohej me energji elektrike, pa njehsor elektrik, përmes një kabllote e lidhur direkt nga shtylla kryesore të cilën kabllot e kanë kontrolluar dhe ka pasur energji elektrike. Fillimisht

konsumatori nuk ka qenë në shtëpi por aty kanë qenë disa edukatore të cilat sigurisht kanë punuar në çerdhen e fëmijëve dhe kanë pritur derisa ka ardhur konsumatori i cili ka qenë prezent gjatë gjithë kohës së kontrollës dhe me atë rast kanë bërë edhe foto në vendin e ngjarjes, ku në foton nr.1 shihet se energjia elektrike vjen pa matje në siguresa, në foton nr.2 shihet koridori i objektit brenda, ku është dashur të jetë i vendosur njehsori elektrik dhe në foton nr.3 shihet se nuk ka të vendosur njehsor elektrik. Më tej dëshmitari ka shtuar se me konstatimet si në procesverbal përkatësisht me gjendjen faktike të konstatuar është pajtuar edhe konsumatori i cili edhe ka nënshkruar procesverbalin një kopje e të cilit i është dorëzuar.

Gjykata ka administruar gjithashtu edhe provën e propozuar nga i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, ashtu që në cilësi të dëshmitarit ka dëgjuar edhe N.K. i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.17.01.2022 ka deklaruar se, të akuzuarin H.K. e njeh që nga fëmijëria, kanë jetuar afër me shtëpia por edhe tani jetojnë. Gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018, fillimisht ka deklaruar se e ka lejuar të akuzuarin H. që të furnizohet për nevojat e familjes së tij në shtëpinë e tij me energji elektrike nga njehsori i tij elektrik, ndërsa më vonë ka deklaruar se nuk i kujtohet se në cilin vit e ka lejuar, duke shtuar se nuk i kujtohet arsyeja pse i akuzuari H. ka kërkuar që të furnizohet me energji elektrike nga njehsori i tij sepse nuk ka hyrë në detaje për ta pyetur se çka i nevojitet energjia. Më pastaj ka deklaruar se ka qenë viti 2016 apo 2017 saktë nuk i kujtohet kur i akuzuari ka kërkuar që të furnizohet me energji elektrike për punime në shtëpinë e tij. Furnizimi nga njehsori i tij për nevojat e shtëpisë së të akuzuarit është bërë përmes një kabloje e cila ende ekziston në oborrin e shtëpisë së dëshmitarit, i cili ka shtuar se kushdo që ka problem me rrymë nga fqinjët ai ja lejon furnizimin përmes kësaj kabloje dhe se energjia e shfrytëzuar nga njehsori i tij nga ana e të akuzuarit është faturuar. Më tej ka theksuar se i kujtohet se gjatë kohës sa i akuzuari është furnizuar me kablo nga njehsori i tij ka qenë duke e ndërtuar shtëpinë dhe nuk ka pas biznes. Energjia elektrike nga njehsori i tij ka qenë duke u shfrytëzuar nga i akuzuari me kablo dhe nuk mund ta shpjegon më në detaje këtë fakt dhe nuk din se a kanë ndryshuar shpenzimet e tija në bazë të faturimit para periudhës shkurt të vitit 2018 dhe pas periudhës shkurt 2018, poashtu nuk e din se prej cilës DPZ të tij janë regjistruar shpenzimet e të akuzuarit Hashim kur është furnizuar me energji elektrike nga njehsori i tij. Nuk e din se për sa kohë e ka shfrytëzuar i akuzuari energjinë elektrike nga kabloja e tij dhe nuk ka njohuri se i akuzuari kabllon e ka shfrytëzuar për furnizim të objektit për biznesin e tij-çerdhe të fëmijëve.

Gjykata ka analizuar deklaratën e dëshmitarit N.K. dhe të njëjtës nuk ja fali besimin pasi që konsideron se deklarata e tij ka qenë e njëanshme, jo bindëse po ashtu ishte në shpërputhje të plotë me të gjitha provat materiale dhe e përgatitur paraprakisht, pasi që të akuzuarin e ka fqinj, dhe mbi të gjitha e njëjta deklaratë ka qenë konfuze sepse dëshmitari fillimisht ka deklaruar se të akuzuarin H. e ka lejuar që të furnizohet për nevojat e familjes së tij në shtëpinë e tij me energji elektrike nga njehsori i tij elektrik gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018, kurse më vonë ka deklaruar se, nuk i kujtohet se në cilin vit e ka lejuar të akuzuarin që të furnizohet me energji elektrike nga njehsori i tij dhe gjithashtu nuk i kujtohet arsyeja pse i akuzuari ka kërkuar që të furnizohet me energji elektrike nga njehsori i tij, derisa gjatë dëshmisë së tij në anën tjetër deklaroi se ka qenë viti 2016 apo 2017 saktë nuk i kujtohet, kur i akuzuari ka kërkuar që të furnizohet me energji elektrike për punime në shtëpinë e tij, mirëpo kjo për gjykatën është vetëm pretendim i dëshmitarit sepse gjykata me asnjë provë nuk ka mund ta vërtetojë faktin se i njëjti me të vërtetë nga njehsori i tij e ka lejuar të furnizohet me energji elektrike të akuzuarin për ushtrimin e biznesit të tij, e aq më pak të vërtetojë faktin se energjia e pretenduar e shfrytëzuar nga ana e të akuzuarit nga njehsori i dëshmitarit është faturuar ashtu siç deklaroi dëshmitari. Sipas qëndrimit të gjykatës, nëse kabllon për furnizim me energji elektrike dëshmitari ja ka lejuar të akuzuarit e cila energji sipas dëshmitarit është faturuar atëherë si ka mundësi që të mos kenë ndryshuar shpenzimet e energjisë elektrike të dëshmitarit, para apo pas periudhës për të cilën akuzohet i

akuzuari, të cilën energji e ka shfrytëzuar për ushtrim biznesi, e po ashtu si ka mundësi që një fqinj si në rastin konkret t'ia mundësojë një fqijut-këtu të akuzuarit që përveç për nevojat e ndërtimit të shtëpisë ndër vite t'ia lejojë furnizimin nga njehsori i tij edhe për ushtrim biznesi. Nëse analizohet dhe vlerësohet me kujdes dëshmia e dëshmitarit të lartcekur, shihet haptazi se i njëjti në vazhdimësi u është shmangur përgjigjeve lidhur me faktet relevante dhe sipas deklaramit të tij, i njëjti kishte tendencë të hapur që dëshmia e tij të shkoj në favor të të akuzuarit me qëllim të liritimit nga përgjegjësia penale-juridike.

I akuzuari H.K. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në vitin 2016 ka blerë shtëpinë e cila gjindet në rrugën "Alajdin Berisha", nga një qytetar serb emri i të cilit është B.L. Atë shtëpi e ka rrënuar në vitin 2017 dhe ka ndërtuar shtëpi të re të cilën e ka përfunduar në mars të vitit 2018 dhe për ndërtimin e shtëpisë ka bërë kërkesë në KEDS për vendosje të njehsorit elektrik për punime të shtëpisë por punëtorët e KEDS-it nuk kanë shkuar për t'ia kryer këtë shërbim dhe pastaj për ndërtimin e shtëpisë është furnizuar me energji elektrike nga fqinji N.K. Është e vërtetë që me dt.23.02.2018 në shtëpinë e tij kanë qenë punëtorët e KEDS-it për kontrollë, L.B. dhe A.G. ku edhe ai personalisht ka qenë prezent dhe si koleg që janë sepse në vendin ku punon, me zyre janë afër dhe në mënyrë shoqërore ju kishte thënë të njëjtëve "se a jeni tranu që keni ardh për kontrollë në gjysmë të natës sepse ora ishte 17:45 min.", pastaj i kishte futur brenda në objekt-shtëpi dhe i ka dërguar tek ormani i njehsorit i cili gjindet në hyrje të shtëpisë në të cilin kanë qenë dy kablllo për të cilat ju kishte treguar se njëra vjen nga N.K. duke ju thënë se, ju si shokë nuk më bëtë nder me ardh me ma lidh njehsorin e ri, derisa njehsorin e vjetër kur e ka rrënuar shtëpinë e ka hudh në mbeturina të cilin pastaj me kërkesë të punëtorëve të KEDS-it e kishte marr nga aty dhe e ka dorëzuar në KEDS. I akuzuari më tej thekson se pas kësaj, po atë ditë punëtorët e KEDS-it ja kanë vendosur njehsorin e ri dhe meqenëse para tre muajve para kontrollës e kishte hapur biznesin familjar-kopshtin e fëmijëve, punëtorët pasi që njehsorin e kishin regjistruar me shifër të biznesit pas disa dite kishte shkuar një kontrollë e KEDS-it nga Prishtina dhe i kishte udhëzuar punëtorët e Prizrenit që të vendosin edhe një njehsor për amvisëri të cilin edhe e kanë vendosur. Te kabllloja e parë të cilën e ka shfrytëzuar nga N.K. kanë qenë të vendosura tri siguresa për arsye se objekti është ndërtuar me material të gatshëm dhe kur punëtorët punonin rreth ndërtimit të shtëpisë ndonjëherë ka pasur pengesa dhe për atë arsye i ka vendosur tri siguresa që mos të shkoj për çdo problem te N. kurse kabllloja tjetër ka qenë e thyer, e mbështjellur me ngjitës. Nga kabllloja e N. ka furnizuar vetëm gjashtë poqe elektrike dhe asgjë më shumë sepse i ka pas dymbëdhjetë tablla-me nxemje diellore. Pas kontrollës rreth kablllos është e vërtetë se e ka nënshkruar procesverbalin e përpiluar nga punëtorët e KEDS-it, me arsye se po e vendosin njehsorin e ri. Të njëjtin nuk e ka lexuar por pas një ore nga kontrolla e ka thirrë L.B. që të shkoj në një lokal afër KEDS-it dhe me fjalë shoqërore i kishte thënë, se kabllon që po e shfrytëzon nga e ka marr, apo përndryshe duhet mej dhanë najë pare A. për me shky procesverbalin e dt.23.02.2018, dhe i akuzuari i kishte thënë, një drekë dhe një darkë si shokë kur doni mundeni me hëngër, pare për me dhanë nuk jap se e di veten që jam i pastër, duke shtuar se për parat e kërkuara nga L. për A. nuk e ka lajmëruar si rast në polici, me arsyetim se parat nuk ua kishte dhënë dhe se i kishte ardh keq ngase L. e kishte bashkëshorten e sëmure nga kanceri dhe të njëjtin e ka pas shokë dhe ende kur takohen përsëriten. Më tej i akuzuari ka shtuar se biznesin-kopshtin e fëmijëve e ka hap tre muaj para kontrollës dhe gjithsejtë i ka pas dymbëdhjetë fëmijë ku kanë punuar bashkëshortja dhe vajzat e tij. Në kopsht ka pas nxemje qendrore nën dysheme me pelet dhe një nxemëse e ka pas në katin e pestë të shtëpisë dhe për biznesin që ka zhvilluar, nga mjetet ka shfrytëzuar një makinë rrobash dhe një frigoriferë të cilat kanë qenë në bodrum të shtëpisë. Biznesin e tij familjar-kopshtin e fëmijëve me emrin e ka ushtruar dikun 5-6 muaj, pastaj e ka mbyllë sepse nuk ka mundur ti rregulloj dokumentacionet për licencimin e tij. Në fjalën përfundimtare i akuzuari ka deklaruar se e

mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij të parashtruar me shkrim duke shtuar se mbrojtjen e tij e ka dhënë sipas realitetin në ditën kritike.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit H.K. dhe nuk ka mundur që të njëjtës t'ia fal besimin, me arsyetim se për ndërtimin e shtëpisë së tij por edhe për ndriçimin e hapësirës së biznesit të tij, kopshtit të fëmijëve është furnizuar me energji elektrike nga fqinji N.K. duke u thirrur gjatë gjithë kohës se në vazhdimësi derisa e ka ndërtuar shtëpinë por edhe gjatë kohës kur punëtorët e KEDS-it në ditën kritike kanë qenë në kontrollë në objekt, ka qenë duke u furnizuar nga një kablo përmes njehsorit të fqiu në fjalë, i cili pretendim me asnjë provë nuk u provua gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se një mbrojtje e tillë nuk është e pranueshme dhe bindëse për gjykatën dhe si e tillë është në kundërshtim edhe me të gjitha provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe me dëshmitë e dëshmitarëve punëtorët e KEDS-it, të cilët kanë deklaruar se me rastin e kontrollës të këtu i akuzuari kanë konstatuar se i njëjti ka qenë pa njehsor elektrik, i kyçur në rrjetin elektrik me lidhje direkte nga shtylla elektrike përmes rrjetit kryesor, ku energjia elektrike nuk është regjistruar, dhe se një mbrojtje e tillë është dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, pasi që është në kundërshtim edhe me të gjitha provat materiale të cilat e vërtetojnë të kundërtën.

Gjendjen faktike si në aktakuzë gjykata e ka vërtetuar edhe nga provat materiale të shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: nga procesverbali me nr.2317388 i dt.23.02.2018, fatura e kalkulimit RH të dt.07.03.2018, fatura e rikthimit të humbjeve me DPZHP 1812743 e dt.07.03.2018, transakcionet e konsumatorit me nr.1830 të dt.26.12.2018, kërkesat e dt.29.03.2016, dt.11.10.2017 dhe dt.06.11.2017, transakcionet e konsumatorit sipas DPZ-9046094 të dt.25.01.2022 dhe DPZ-1827 të dt.17.11.2021 në emër të N. (I) K. si dhe foto dokumentacioni i bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Nga procesverbali me nr.2317388 i dt.23.02.2018, i përpiluar nga personat e autorizuar të KEDS-it në Prizren, vërtetohet se konsumatori-këtu i akuzuari H.K. në momentin e kontrollës në objektin-kopshtin e fëmijëve është hasur se energjinë elektrike e shfrytëzon pa njehsor elektrik, dhe atë në mënyrë direkte, ku pas kontrollës dhe të gjeturave në vendin e ngjarjes i është vendosur njehsori i ri me nr.67793761, dhe pastaj është marrë fuqia matëse për pajisjet elektrike shpenzuese si: një (1) shporet elektrik-fuqia (W) 7500, një (1) nxemëse UFO-fuqia (W) 3000, një (1) bojlerë-fuqia (W) 2000, një (1) lavatriqe-fuqia (W) 3000, një (1) rrobatharëse-fuqia (W) 3500, një (1) TV-fuqia (W) 150, dhe 30 ndriçues-fuqia (W) 40.

Nga fatura e kalkulimit RH të dt.07.03.2018, dhe fatura e rikthimit të humbjeve sipas DPZHP 1812743 e dt.07.03.2018, vërtetohet periudha kohore, lidhur me kalkulimin e faturimit të energjisë së shpenzuar në mënyrë të paautorizuar nga ana e të akuzuarit.

Nga transakcionet e konsumatorit me nr.1830 të dt.26.12.2018, e cila figuron në emër të Budimir Lekiq, e të cilën e shfrytëzon këtu i akuzuari H.K. të cilin fakt e ka pohuar gjatë shqyrtimit gjyqësor edhe vet i akuzuari, rezulton historiati i faturimit për energjinë e shpenzuar nga ana e të akuzuarit, sipas së cilit rezulton se i akuzuari është faturuar në vazhdimësi por edhe në periudhën për të cilën ngarkohet, dhe fakti se si është faturuar dhe për cilën periudhë për gjykatën nuk është objekt i kësaj çështje penale, por objekt i aktakuzës është shfrytëzimi i energjisë elektrike në momentin e kontrollës nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, pa njehsor elektrik e të cilin fakt e ka pohuar edhe i akuzuari.

Nga foto dokumentacioni shihet kabloja përmes së cilës i akuzuari ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte, pa njehsor elektrik, ku energjia elektrike nuk është regjistruar.

Nga transakcionet e konsumatorit sipas DPZ-9046094 të dt.25.01.2022 dhe DPZ-1827 të dt.17.11.2021 në emër të N. (I) K. vërtetohet fakti se në periudhën kur i akuzuari pretendon se ka shfrytëzuar energjinë elektrike nga njehsori i këtij konsumatori, shpenzimet mujore të dëshmitarit nuk kanë ndryshuar fare dhe janë të njëjta si para periudhës së dt.23.02.2018, e poashtu edhe pas kësaj periudhe. Atëherë shtrohet pyetja nga ana e gjykatës, si ka mundësi që i akuzuari të furnizohet nga njehsori i dëshmitarit për një periudhë bukur të gjatë, nga ndërtimi i shtëpisë e deri gjatë kohës së ushtrimit të biznesit të tij familjar dhe të mos ketë ndryshim në shpenzimet mujore të energjisë elektrike të dëshmitarit në fjalë.

Nga referencat e dt.29.03.2016, 11.10.2017 dhe 06.11.2017, konstatohet se janë bërë disa kërkesa për njehsor, fakt ky i pakontestueshëm për gjykatën, por edhe përkundër kësaj kjo nuk e arsyeton faktin se i akuzuari energjinë elektrike ka mundur ta shfrytëzoj pa njehsor elektrik me lidhje direkte, pa faturim të energjisë elektrike.

Poashtu gjykata ka analizuar edhe tezën e mbrojtësit të akuzuarit av.A.H. se i mbrojturi i tij nuk ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga shfrytëzimi i energjisë elektrike pa njehsor, ngase energjinë e shpenzuar e ka marrë nga fqiu i tij N.K. i cili edhe e ka paguar dhe deri te kjo situatë ka ardhur jo me qëllimin e të pandehurit por nga neglizhenca e vetë KEDS-it, i cili nuk ka vepruar edhe pas tri kërkesave të të pandehurit për vendosjen e njehsorit elektrik, ashtu që pasi që nuk ka qëllim dhe dashje në rastin konkret nuk ka as vepër penale, ngase vepra penale e kësaj natyre kryhet me dashje të drejtpërdrejtë. Sipas qëndrimit të gjykatës kjo tezë nuk qëndron sepse gjatë administrimit të provave me asnjë provë nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari ka shfrytëzuar energjinë elektrike nga njehsori i fqiu të tij-dëshmitarit N.K. e kjo nuk është vërtetuar as nga transakcionet e konsumatorit-dëshmitarit në rastin konkret- për dy njehsorët e tij, nga të cilët rezulton se gjatë periudhës kur pretendohet se i akuzuari ka shfrytëzuar energjinë nga njehsori i tij nuk ka ndryshime në shpenzime të energjisë elektrike dhe se faktin se ditën kritike nuk ka pasur të vendosur njehsori elektrik e ka pohuar edhe vet i akuzuari, e këtë fakt e vërtetojnë edhe deklaratat e dëshmitarëve-zyrtarë të KEDS-it. Ndërsa pretendimet e mbrojtësit se, punëtorët e KEDS-it ditën kritike kërkojnë nga i pandehuri që ta nënshkruajnë procesverbalin dhe ate jo në vendin e duhur por në fillim të tij, me arsyetim se ky proces ka të bëjë me vendosjen e njehsorit të ri, këto janë vetëm supozime të mbrojtësit pasi që nga provat materiale del se i akuzuari e ka nënshkruar procesverbalin me konstatimet e ditës kritike dhe ate si shfrytëzues i njehsorit elektrik, po ashtu ka dhënë edhe shënime të tij personale dhe sipas qëndrimit të gjykatës i akuzuari ka qenë i vetëdijshtëm për konstatimet si në procesverbalin e nënshkruar të dt.23.02.2018, duke pas parasysh faktin se i njëjti në këtë drejtim ka pasur njohuri të mjaftueshme për procedurat në fjalë meqenëse edhe vet është punëtor-zyrtarë në “Hidroregjionin Jugor” në Prizren, ashtu që gjykata vlerëson se i njëjti nuk ka rënë pre e punëtorëve të KEDS-it siq pretendon mbrojtësi i të akuzuarit e sidomos duke pas parasysh faktin se i njëjti ka deklaruar se punëtorin L.B. i cili ditën kritike ka qenë për kontrollë në objektin e tij e ka pas shokë. Gjithashtu pretendimi se deri te kjo situatë e ditës kritike ka ardhur jo me qëllimin e të pandehurit por nga neglizhenca e vetë KEDS-it, i cili nuk ka vepruar edhe pas tri kërkesave të të pandehurit për vendosjen e njehsorit elektrik, ashtu që pasi që nuk ka qëllim dhe dashje në rastin konkret nuk ka as vepër penale, ngase vepra penale e kësaj natyre kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, për gjykatën është i papranueshëm sepse fakti se punëtorët e KEDS-it kanë qenë neglizhent dhe nuk kanë vepruar sipas tri kërkesave të pandehurit për vendosjen e njehsorit të ri, nuk e arsyeton veprimin e të akuzuarit për furnizim të energjisë elektrike pa njehsor për zhvillimin e biznesit të

tij familjar. Andaj gjykata konsideron se provat materiale por edhe ato personale të administruara në shqyrtimin gjyqësor e dëshmojnë të kundërtën e pretendimeve të mbrojtësit të akuzuarit sidomos procesverbali me nr.2317388 i dt.23.02.2018.

Gjykata pas administrimit të të gjitha provave materiale, dëgjimit të akuzuarit dhe dëshmitarëve, konstatoi se në rastin konkret i akuzuari H.K. pasi që ka blerë shtëpi në Prizren nga personi me emrin B.L. njehsorin e së cilës e ka shfrytëzuar sipas shifrës së konsumatorit 1830, i regjistruar në emër të këtij qytetari, të cilën shtëpi pastaj e ka rrënuar gjatë vitit 2016 dhe në vend të saj ka ndërtuar shtëpi të re, ku në katin e parë të saj gjatë vitit 2018 ka pasur të hapur edhe biznesin e tij familjar-kopshtin e fëmijëve “Arta” fakt ky i pohuar edhe nga vetë i akuzuari, në të cilin objekt ditën kritike me rastin e kontrollës së ushtruar nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, është hasur se i akuzuari në biznesin e tij familjar-kopshtin e fëmijëve energjinë elektrike e ka shfrytëzuar pa njehsor elektrik dhe ka qenë i kyqur në rrjetin elektrik me lidhje direkte nga shtylla elektrike përmes rrjetit kryesor. Ky keqpërdorim i energjisë është konstatuar përmes procesverbalit me nr.2317388 të dt.23.02.2018, nga zyrtarët e KEDS-it pas kontrollës në objekt, po ashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu që sipas qëndrimit të gjykatës e gjithë kjo është bërë me qëllim të përfitimit material nga ana e të akuzuarit, ndërsa bazuar në këtë procesverbal, pas kontrollës së kryer në objekt është bërë edhe matja e fuqisë së pajisjeve elektrike të cilat i ka pas në shfrytëzim i akuzuari, me ç’rast rezulton se të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material. Sipas qëndrimit të gjykatës të gjitha veprimet e kundërligjshme nga ana e të akuzuarit janë kryer me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete nga e cila rezulton se veprimet e tilla i ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta kundërligjore dhe ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke analizuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Hashim Kryeziu, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPK-së, me të cilën e ngarkon aktakuza, andaj gjykata të njëjtin e ka shpallur fajtorë dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të KPP-së, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se është familjar, baba i pesë fëmijëve, se në procesin gjyqësor ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës dhe sipas evidencës së kësaj gjykate është hera e parë që i njëjti ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar me kusht, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe në të ardhmen do ta parandalojë në kryerjen e veprave penale.

Vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe nenit 451 par.1 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par. 3 pika 1 të Ligjit nr.05/L-036.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2018:021422
P.nr.875/2018, më datë 24.02.2022

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.